



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË
MINISTARSTVO ZA TRGOVINU I INDUSTRIJU
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

PROFILI I SEKTORIT TIK

SEKTORI I KONTRAKTIMIT TË
SECTOR PROFILE OF THE
PROCESEVE TË PUNËS DHE QENDRAVE
WOODPËRPËRKRAHJEPROCESSINGTËKONSUMATORËVEINDUSTRY





PROFILI I SEKTORIT TIK
SEKTORI I KONTRAKTIMIT TË
PROCESEVE TË PUNËS DHE
QENDRAVE PËR PËRKRAHJE
TË KONSUMATORËVE

Mirënjohjet dhe Falenderimet

Ky raport është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës brenda kornizës së angazhimeve përmes projektit “Ndihmë Tregtisë”, implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



MINISTRY FOR FOREIGN
AFFAIRS OF FINLAND

Për realizimin e këtij raporti kontribut i veçant është dhënë nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë:

Kabineti i Ministrit
Departamenti i Industrisë
Departamenti i Integritimeve Evropiane dhe Koordinimit të Politikave
Agjencia për Mbështetje të Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë

Anketimi në terren realizuar nga TNS Index Kosova, Agjenci për hulumtime sociale, të mediave dhe marketingut

Kontrolli i Cilësisë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Kosovë
Njësia për Politika, Hulumtime, Çështje gjinore dhe komunikim
Njësia për Zhvillim Gjithpërfshirës
Projekti “Ndihmë Tregtisë”
Petr Gashi, Phd – Konsulent i Jashtëm

Autor

Diedon Kica

Përkthyes në gjuhën Shqipe:

Hyjnor Jasiqi

Dizajni: “XHAD Studio”, Prishtinë

Shtypi: “Grafika Reznici” Prishtinë

Si dhe një falenderim i veçantë për të gjithë respondentët e përfshirë në hulumtim.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të pjesëmarrësve dhe të autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqësojnë qëndrimet zyrtare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës.

E drejta autoriale © 2014. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja

Mirënjohjet dhe Falenderimet	2
Lista e shkurtesave.....	4
1. Hyrje	5
2. Të dhënat themelore të kompanive	7
2.1. Numri i kompanive të regjistruara në këtë industri.....	7
2.3. Ndarja e kompanive të kësaj industrie sipas madhësisë dhe vendndodhjes.....	8
2.4. Ndarja e industrisë sipas veprimtarisë.....	9
2.5. Pronësia, struktura ligjore dhe mosha e kompanive të industrisë	10
2.7. Mosha, gjinia dhe etnia e pronarit (kryesor) të kompanisë	11
3. Kontributi dhe prodhimi i kompanive/industrisë.....	14
3.1. Lënda e parë dhe materialet e ndërmjetme	14
3.2. Energjia elektrike dhe komunalitë.....	14
3.3. Struktura e materialeve të ndërmjetme (lokale kundrejt të huaja)	15
3.4. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe vlera e prodhimit	17
4. Tregjet	19
4.1. Qarkullimi	19
4.2. Produktet, shërbimet dhe kanalet lokale	20
4.3. Shitjet vendore kundrejt shitjeve jashtë vendit	21
4.4. Eksportet	22
5. Punësimi dhe burimet njerëzore në kompani/industri	29
5.1. Numri i të punësuarve dhe kostoja e punës.....	29
5.2. Struktura e arsimimit, trajnimit dhe zhvillimit.....	30
5.3. Perceptimet e bizneseve lidhur me nivelin e përgatitjes së fuqisë punëtore ...	31
6. Investimet e kompanive/industrisë dhe niveli teknologjik	35
6.1. Investimet e firmave, H&ZH dhe inovacionet, dhe prona industriale	35
7. Mjedis afarist.....	38
7.1. Perceptimet lidhur me pengesat kryesore për zhvillimin e afarizmit	38
7.2. Perceptimet e bizneseve lidhur me politikat tatimore dhe administratën tatimore ..	39
7.3. Perceptimet e bizneseve lidhur me doganën dhe sektorin financiar	40
8. Konkluzion.....	42
9. Shtojcat.....	44
Shtojca 1: Institucionet publike që ndërlidhen me sektorin e TIK	44
Shtojca 2: Shoqatat afariste në sektorin e TIK	45
Shtojca 3: Stimulimi i bizneseve që veprojnë në sektorin e TIK	46
Shtojca 4: Legjislacioni, rregulloret, licencat dhe lejet e kërkuara.....	47
Shtojca 5: Legjislacioni lidhur me pronën industriale dhe patenta	48
Shtojca 6: Legjislacioni tjetër që ndërlidhet me sektorin e TIK	49
Punimet e cituara.....	50

Lista e shkurtesave

KPA	Kontraktimi i Proceseve Afariste
QPK	Qendrat për Përkrahje të Konsumatorëve
TIK	Teknologjia Informativë dhe e Komunikimit
TI	Teknologjia Informativë
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

1. Hyrje

Ky profil i sektorit ofron informata mbi gjendjen aktuale të sektorit të TIK në Kosovë, duke u përqëndruar kryesisht në veprimtaritë e kontraktimit të jashtëm të proceseve afariste (KPA) dhe të qendrave për përkrahjen e konsumatorëve (QPK). Qëllimi i këtij dokumenti është që të paraqesë profilin që përshkruan gjendjen aktuale, identifikon pengesat dhe vlerëson produktivitetin relevant të sektorit, si dhe potencialin e tij.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar nga pesë burime të ndryshme. Përshkrimi i industrisë bazohet në të dhënat e nxjerra nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), intervistat me personelin e Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit në Kosovë (STIKK)¹, si dhe në anketat e realizuara nga STIKK. Informatat mbi eksportet dhe importet e këtij sektori bazohen në të dhënat e grumbulluara nga Doganat e Kosovës. Përveç disa rasteve të caktuara, të dhënat e treguesve në nivel të firmave kalkulohen në bazë të anketës së kryer nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në tetor-nëntor të vitit 2013. Këto situata plotësohen me të dhënat e nxjerra nga anketat e lartpërmendura të STIKK. Mostra e kësaj ankete është bazuar në listën e anëtarëve të STIKK (76 kompani) dhe ka përfshirë 4 kompani tjera të cilat dihet se janë aktive në këtë sektor. Të dhënat janë nxjerrë nga shumë burime të ndryshme, për shkak të mungesës së të dhënave dhe kategorive të definuara për raportim të aktiviteteve të sektorit të TIK-KPA-QPK në Kosovë. Sa i përket metodologjisë, janë përdorur metodat e hulumtimit primar dhe sekondar, përfshirë hulumtimet teorike dhe intervistat. Hulumtimet teorike janë kryer gjatë shtatorit dhe nëntorit, ndërsa rezultatet e anketës kanë qenë të gatshme nga mesi i dhjetorit. Mostra e anketës së UNDP-së përfshinte 23 kompani që janë aktive në sektorin e KPA dhe/ose QPK: 11 mikro, 9 të vogla, 1 e mesme dhe 2 të mëdha.

Sektori i TIK-KPA-QPK është sektor me potencial për punësimin e të rinjve dhe zhvillim të inovacioneve, i cili do të mund të ndihmonte në zhvillimin ekonomik të Kosovës në aspekt afatgjatë. Aktualisht, në këtë sektor ekzistojnë 220 kompani të regjistruara, mes të cilave 120 konsiderohet se janë aktive. Në bazë të përgjigjeve të pranuara nga bizneset që kanë deklaruar se operojnë në sektorin e KPA dhe/ ose QPK-së, mund të thuhet se përafërsisht 20% e bizneseve janë të involvuara drejtpërsëdrejti në këtë sektor. Shumica e bizneseve në fushën e TIK ofrojnë produkte apo shërbime të ndërlidhura me telekomunikacionin, këshillimin lidhur me harduerin, këshillimin lidhur me softuerin dhe furnizimin, dhe janë të angazhuar në veprimtari tjera të ndërlidhura me botën kompjuterike. Ndryshimet më të theksuara pozitive në veprimtarinë e këtij sektori vërehen në i) trajnim, certifikim dhe konsulencë, ii) zhvillim softueri dhe programim, dhe iii) sigurim të shërbimeve të internetit. Në kuptim të ndarjes gjeografike, 45% të kompanive ndodhen në komunën e Prishtinës, ndërsa 84.5% të tyre kanë më pak se 10 punëtorë. Përveç kësaj, 87% të kompanive në fushën e TIK janë pronë e plotë e Kosovarëve, ndërsa shumica prej tyre janë biznese individuale.

1. STIKK - Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës.

Kompanitë e anketuara kanë raportuar se mesatarisht lënda e parë dhe produktet e ndërmjetme përbëjnë 67.7% të kostove të tyre të përgjithshme, ndërsa pagat zënë vendin e dytë në këtë listë (22.6%). Sa i përket vlerës së produkteve, rezultatet zbulojnë se mes kompanive ekzistojnë dallime të mëdha. Bizneset që gjatë intervalit kanë gjeneruar mes €250,001 dhe €500,000 kanë pësuar ndryshimet më negative, ndërsa numri i atyre që kanë gjeneruar €10,000 ose më pak është shtuar. Sa i përket shfrytëzimit të kapaciteteve, nga viti 2011 në vitin 2012 është shënuar një rritje pozitive prej 24%. Përveç kësaj, 44.4% të kompanive kanë deklaruar se gjatë vitit 2012 kanë gjeneruar mes €250,001-€500,000. Edhe pse kompanitë që kanë raportuar një gjë të tillë gjatë këtij intervali në vitin 2012 ka rënë për 5.6 pikë përqindjeje në krahasim me vitin 2011 (rënie prej 11.2%). Shtatëdhjetepesë për qind të kompanive të anketuara kanë raportuar se shesin mbi 90% të produkteve dhe shërbimeve të tyre në vend. Kur krahasojmë shifrat e vitit 2011 me ato të vitit 2012, shohim se shitjet vendore dhe ndërkombëtare kanë qëndruar relativisht stabile. Në përgjithësi, sektori i TIK ka pasur deficit tregtar prej 50.5 milionë euro në vitin 2012, duke eksportuar mallra dhe shërbime në vlerë prej vetëm 210,661 eurosh. Ndërsa vetëm një pjesë e vogël e këtyre eksporteve janë kryer në Shtete të Bashkuara dhe Kanada (9%), pjesa më e madhe e eksportit u realizua drejt shteteve të Ballkanit (67%). Sa u përket kanaleve të eksportit, 71.4% kanë raportuar se produktet ua shesin shitësve me pakicë, ndërsa vetëm 30.4% ua shesin produktet e tyre konsumatorëve apo përdoruesve fundorë.

Fuqia punëtore e përgjithshme e angazhuar në industrinë e TIK gjatë vitit 2013 ishte rreth 1,716 persona, ndërsa supozohet se rreth 334 persona kanë qenë të punësuar gjatë vitit 2012 në sektorin e KPA/QPK. Kompanitë e angazhuara në këtë sektor kanë raportuar se 74% të punonjësve të tij kanë tituj universitarë apo të arsimimit superior. Perceptimet e bizneseve nga sektori i KPA/QPK lidhur me nivelin e aftësive të fuqisë punëtore të angazhuar janë relativisht pozitive, duke qenë se vetëm 19% të kompanive janë përgjigjur se punëtorët me aftësi adekuate gjenden me vështirësi. Lidhur me teknologjinë dhe makinerinë, 86% të kompanive të intervistuar kanë pronësi mbi asetet e tyre dhe vlera mesatare e tregut e të njëjtave është rreth €11,000. Megjithatë, 31% nuk kanë investuar në produktet apo shërbimet e tyre gjatë vitit 2012.

Në bazë të të intervistuarve, taksat përbëjnë pengesën kryesore të bizneseve, përcjellë nga niveli i lartë i korrupsionit dhe efikasiteti i ulët i administratës tatimore. Gjashtëdhjetenjë për qind të të anketuarve u përgjigjën se taksat janë ose 'të larta' ose 'shumë të larta', ndërsa vetëm 5% thanë se taksat janë 'shumë të ulëta'. Për më tepër, sektori i KPA/QPK nuk është stimuluar aq sa duhet për ta arritur potencialin e vet të plotë. Brenda strukturave aktuale qeverisëse nuk ekzistojnë kurrfarë strukturash qeverisëse, agjencish, programesh përkrahëse apo politikash. Ekziston nevoja për përkrahje më të madhe për kompanitë e TIK dhe fuqinë punëtore të angazhuar në to, për miratim të nismave për KPA dhe për krijimin e kushteve të cilat do të mund të tërhiqnin investime të drejtpërdrejta të huaja në këtë sektor.

2. Të dhënat themelore të kompanive

2.1. Numri i kompanive të regjistruara në këtë industri

Në bazë të bazës së të dhënave të ARBK-së, në fund të vitit 2013 në sektorin e TIK vepronin 220 biznese të regjistruara (Tabela 1).²


Tabela 1: Biznese të regjistruara në TIK

Viti	2010	2011	2012	2013 ³
Nr.	188	165	219	220

Burimi: ARBK, 2013

Shumica e kompanive janë të regjistruara si veprimtari të tyre parësore 1) telekomunikacionin, këshillimet harduerike, 3) këshillimet tjera softuerike dhe furnizimin e tij; dhe 4) veprimtari tjera kompjuterike (Figura 1). Është me rëndësi të theksohet se rreth 15% të bizneseve që kanë telekomunikacionin si fushëveprimtari primare të tyre janë, në fakt, *internet kafe* të vogla apo biznese tjera që punojnë me pakicë. Lista e kompanive të regjistruara mund të përfshijë edhe dyqane tjera të cilat jo domosdoshmërisht përkufizohen si kompani të TI nga komuniteti i TIK.

Figura 1: Numri i bizneseve të regjistruara sipas veprimtarisë, 2010-2013



Burimi: ARBK, 2013

2. Filtruar duke shfrytëzuar veprimtaritë afariste primare nga kodet: 3002, 6420, 7210, 7222, 7230, 7240, 7250, 7260.

3. Për vitin 2013, të dhënat e bizneseve të regjistruara përfshijnë periudhën deri 22 nëntor

Në bazë të bazës së të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2013, 245 biznese aktive veprojnë në këtë sektor. Megjithatë, të dhënat e ATK dhe ARBK lidhur me veprimtarinë afariste të bizneseve dallojnë (Tabela 2).

Tabela 2: Dallimet mes bazave të të dhënave të ARBK dhe AKT


Veprimtaria afariste	Numri i bizneseve (ARBK 2013)	Numri i bizneseve (ATK 2013)*
Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve tjera për përpunimin e informatave	1	0
Telekomunikimi	139	186
Këshillimi lidhur me harduerin	21	24
Këshillimi lidhur me softuerin dhe furnizimi i tij	41	0
Përpunimi i të dhënave	4	10
Aktivitetet e ndërlidhura me bazat e të dhënave	1	1
Makineria kompjuterike dhe mirëmbajtja e zyrave	3	13
Veprimtari tjera të ndërlidhura me kompjuterë	10	11

Marrë parasysh të dhënat nga këto dy institucione, bëhet e qartë se ekzistojnë disa mospërputhje sa i përket veprimtarive kryesore afariste të bizneseve. Të dhënat e STIKK, në anën tjetër, supozojnë se në sektorin e TIK aktive janë gjithsej 120 kompani.⁴ Për më tepër, marrë parasysh normën e përgjigjeve sa i përket angazhimit në veprimtari me KPA dhe/ose QPK nga mostra e anketuar, mund të supozohet se rreth 20% të këtyre bizneseve janë drejtpërdrejt të përfshira në sektorin e KPA-QPK.

2.2. Ndarja e kompanive të kësaj industrie sipas madhësisë dhe vendndodhjes

Shumica e kompanive në sektorin e TIK janë biznese mikro dhe të vogla. Sipas bazës së të dhënave të AKT-së, 84.5% janë mikrobiznese, 12.7% janë të vogla, 2.4% janë të mesme, 0.4% janë ndërmarrje të mëdha (Figura 2).

Figura 3: Ndarja e bizneseve sipas madhësisë (numrit të punonjësve)



4. STIKK (dhjetor 2013) - www.stikk.com

* Për vitin 2013, të dhënat e bizneseve të regjistruara përfshijnë periudhën deri 22 nëntor

Rreth 45.3% të bizneseve në fushën e TIK ndodhen në Prishtinë, ndërsa Prizreni zë vendin e dytë në këtë listë me 9.8% të bizneseve të regjistruara. (Tabela 3)

Tabela 3: Vendndodhja e bizneseve

Komuna	Biznese	Përqindja (%)
Prishtinë	111	45.3%
Prizren	24	9.8%
Ferizaj	13	5.3%
Gjilan	13	5.3%
Tjera (<5.3%)	84	34.3%

Burimi: ATK, 2013

2.3. Ndarja e industrisë sipas veprimtarisë

Nga analizimi i anketës së STIKK lidhur me veprimtarinë afariste përbrenda sektorit të TIK, vërehen disa ndryshime të cilat pasqyrojnë disa lëvizje të vogla brenda industrisë (Tabela 4).

Tabela 4 : Veprimtaria afariste⁵

Veprimtaria afariste e kompanive të sektorit të TIK	2010	2013
Ofrimi i shërbimeve të internetit	7.7%	25.0%
Trajnimi/Certifikimi dhe Këshillimi	13.2%	34.0%
Mirëmbajtja dhe riparimi	17.6%	29.0%
Shërbimet informative	11.0%	6.0%
Zhvillimi i softuerit/programimi	13.2%	28.0%
Shitja (harduer dhe/ose softuer)	33.0%	12.0%
Prodhimi/montimi	8.8%	5.0%
Shitja me pakicë	18.7%	5.0%
Shërbimet bankare elektronike dhe e-afarizmi	1.1%	2.0%
Operimi i rrjeteve dhe sistemeve/menaxhimi	-	12.0%
Kontraktimi i Proceseve Afariste (KPA)	1.1%	-
Shërbimet inxhinierike	4.4%	-
Të tjera	-	3.0%

Burimi: STIKK, 2013

Siç mund të kuptohet nga tabela më sipër, numri i kompanive që merren me shitje të harduerit dhe/ose softuerit ka shënuar rënie nga viti 2010. Gjithashtu, ekzistojnë shumë arsye për këtë. Përveç kërkesës, mund të ndodhë që bizneset të kenë filluar të bartin resurset e tyre drejt ofrimit të zgjidhjeve dhe shërbimeve më të veçanta dhe më pak gjenerike. Kjo tezë mund të përkrahet pjesërisht nga rritja e numrit të kompanive të cilat kanë vendosur zhvillimin e softuerit dhe programimin si veprimtari të tyre. Është evidente jo vetëm nga ky fakt por edhe numri më i madh bizneseve dhe nga shtimi i kërkesës për furnizim dhe cilësi të shërbimeve të tilla në treg. Një ndryshim

5. Kjo tabelë dhe informatat e paraqitura në të janë marrë me leje të STIKK (Analiza e Mangësisë së Shkathtësive, 2013, STIKK-EYE) - www.stikk-ks.org

tjetër i dukshëm vërehet në trajnim, certifikim dhe këshillim, që është indikacion se bizneset dhe klientët e këtij sektori janë duke u bërë çdo herë e më të vetëdijshëm mbi kompleksitetin e zgjidhjeve të TIK dhe mbi nevojën për trajnime dhe edukim të mëtejshëm. Megjithatë, veprimtaritë kyçe, siç janë shërbimet elektronike bankare dhe e-afarizmi ende nuk kanë arritur nivelin e duhur.

2.4. Pronësia, struktura ligjore dhe mosha e kompanive të industrisë

Aktualisht 87% të kompanive të TIK janë në pronë të plotë të kosovarëve, ndërsa në vitin 2010 kjo përqindje ishte për 7% më e ulët (Tabela 5). Vetëm 8% të kompanive janë në pronë ekskluzive të të huajve, ndërsa që kjo përqindje nuk ka ndryshuar shumë viteve të kaluara.

Tabela 5: Struktura pronësore⁶

Pronësia mbi kompanitë	2010	2013
100% në pronë të kosovarëve	80%	87%
Shumica e aksioneve në pronë të kosovarëve	0%	2%
50-50 pronë e kosovarëve/të huajve	3%	3%
100% kompani në pronë të të huajve	7%	8%
Tjetër/Pa përgjigje	10%	-

Burimi: STIKK, 2013

Nga këndvështrimi ligjor, shumica e kompanive janë biznese individuale dhe kompani me përgjegjësi të kufizuar, ndërsa vetëm 6% të tyre janë të regjistruara si shoqëri aksionare (Tabela 6).

Tabela 6: Struktura ligjore⁷

Lloji i kompanisë	2010	2013
Biznese individuale	53.8%	59%
Partneritete të kufizuara	4.4%	12%
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	28.6%	23%
Shoqëri aksionare	2.2%	6%
Tjetër/Pa përgjigje	11.0%	-

Burimi: STIKK, 2013

Të dhënat e anketës tregojnë se 74% të bizneseve në sektorin e TIK janë themeluar mes viteve 2000 dhe 2009, ndërsa vetëm 8% janë themeluar pas vitit 2010 dhe 18% kanë ekzistuar para vitit 1999 (Tabela 7).

6. Po aty.

7. Po aty.

Tabela 7: Struktura e moshës⁸


Viti i themelimit	Përqindja e kompanive
Pas vitit 2010	8%
2000 - 2009	74%
Para vitit 1999	18%

Burimi: STIKK, 2013

2.5. Moshë, gjinia dhe etnia e pronarit (kryesor) të kompanisë

Shumica e pronarëve të intervistuar të firmave KPA-QPK kanë raportuar se janë mes 20 dhe 49 vjeçar. Përderisa një pjesë e mirë e tyre (35%) janë të moshës 30-39 vjeçare, vetëm 12% të firmave kanë raportuar të kenë pronarë të moshës 50-59 vjeçare (Figura 3).

Figura 3: Struktura e moshës së pronarëve të kompanive në sektorin e KPA-QPK



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Ndarja e këtyre të dhënave sipas gjinisë zbulon se 87% të pronarëve të bizneseve janë meshkuj ndërsa vetëm 13% janë gra. Sa i përket përkatësisë etnike, 4.3% të pronarëve kanë raportuar se nuk i përkasin etnisë shqiptare.

8. Po aty.

Rubrika 1 - Profili i një biznesi të suksesshëm që vepron në Kosovë

3CIS ofron shërbime profesionale dhe cilësore për ndërmarrje të mëdha të telekomunikacionit dhe ka filluar si pilot projekt dhe nënkontraktor i prodhuesit të pa-jisjeve të telekomunikacionit - Tellabs. Që atëherë, kjo kompani është rritur me shpejtësi, duke ngritur numrin e punëtorëve nga disa në 150 sish, dhe duke vazhduar të jetë shembull i rritjes së qëndrueshme dhe rrjedhës pozitive të parasë. Shërbimet e kësaj kompanie sillen rreth rrjeteve 3G, 4G & LTE, End-to -End Backhaul, Dizajnit Arkitektonik të Rrjeteve, OSS, R&D, Testimin dhe Trajnimit të Laboratorëve, Inxhinierisë Softuerike dhe projekteve të menaxhimit të kapaciteteve për (mes tjerash) kompani të mëdha të telekomunikacionit. 3CIS ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë tregjeve globale në Amerikë Veriore dhe Evropë, Lindje të Mesme dhe Afrikë.

Hyrja në tregun global, duke u shërbyer kompanive botërore të telekomunikacionit, kërkon përkushtim, shërbime cilësore dhe fuqi punëtore profesionale dhe të trajnuar. Këto kërkesa vijnë si rezultat i rolit kyç që shërbimet e tilla kanë për bizneset në fushën e telekomunikacionit dhe i ndikimit potencial negativ që mund të kenë gabimet e vogla. Kjo industri njihet për nga konkurrenca e rreptë dhe përzgjedhja tejet agresive e shërbimeve që i kontraktin jashtë. Megjithatë, 3CIS ka arritur t'ia dëshmojë partnerëve dhe klientëve të vet se mund t'ua përmbushë nevojat e tyre. Nëse i kthehemi prapa zanafillës së kësaj ndërmarrjeje dhe përpikemi të vlerësojmë se çka bëri që ky biznes të jetë i suksesshëm, duhet t'i kemi parasysh disa faktorë.

Së pari, 3CIS ka pasur një vizion tejet frymëzues dhe të guximshëm, përcjellë me përkushtim dhe profesionalizëm të pashoq. Në vitin 2008, shumica e kompanive të Kosovës mëtonin konkurrimin në tregun vendor, ndërsa themeluesit e 3CIS kishin guximin që të mendojnë dhe të kërkojnë mundësi jashtë vendit. Falë përvojës profesionale dhe ekspertizës së tyre, ata deshën të sfidojnë veten në nivel global dhe të garojnë me kompanitë që ofrojnë shërbimet më të cilësore. Kjo u lejonte atyre që të marrin përsipër rreziqe dhe të fillojnë me projekte të vogla, ndërsa u dëshmonin klientëve dhe partnerëve të tyre se kanë përvojë dhe njohuri për të marrë edhe projekte më të mëdha në të ardhmen (Pula, 2013).

Së dyti, 3CIS ishte përqendruar intenzivisht në arsimimin e fuqisë së vet punëtore dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve. Përkrah komunikimit johierarkik në tërë organizatën që mundëson këmbimin e njohurive mes tërë stafit, 3CIS u ofron punëtorëve të vet trajnime të shumta në vend të punës. 3CIS shfrytëzon praktikën më të mira ndërkombëtare dhe sistemet ndërkombëtare të certifikimit në ngritjen e kapaciteteve të fuqisë punëtore të vet. Për më tepër, ata përdorin simulime reale, duke i shfrytëzuar teknologjitë më moderne, me qëllim të realizimit të punës prak-tike dhe trajnimeve, me qëllim të përgatitjes së punëtorëve për jetësimin e projekteve të vërteta. Ky investim i madh në arsimim kontribuon në shërbimet tejet cilësore të cilat arrijnë t'i ofrojnë për klientët e tyre.

Së treti, kjo kompani gëzon qasje në tregjet globale, përmes lidhjeve profesionale dhe partnerëve. Një nga themeluesit e saj, Kujtim Tali, veç ka përvojë të madhe në këtë industri, duke qenë se para vitit 2008 ka punuar në SHBA me partnerë të ndryshëm në fushën e telekomunikacionit. Kjo ekspertizë dhe rrjetëzimi social janë dëshmuar se janë kyçe për zhvillimin e kompanisë. Përveç faktit se janë në gjendje ta ndajnë këtë përvojë me të tjerët dhe t'ia bartin një pjesë të ekspertizës së pronarëve themeluesve dhe pronarëve tjerë, përvoja e Kujtimit i ka ndihmuar 3CIS-it

edhe në krijimin e marrëdhënieve solide me Tellabs dhe partnerët tjerë relevantë. Për më tepër, 3CIS ishte në gjendje t'u ofrojë partnerëve dhe klientëve të vet çmime tejet konkurruese për shërbime tejet cilësore, duke i ndihmuar kështu kompanisë krijimin gradual të partneriteteve anëmbanë botës.

Së katërti, kjo kompani ka treguar këmbëngulje dhe përkushtim në përballje me sfidat dhe barrierat e ndryshme në Kosovë. 3CIS ka pasur shumë probleme të ndërlidhura me mjedisin afarist dhe rregullativ në Kosovë; tregun e shërbimeve të sigurimit; cilësinë e institucioneve arsimore; dhe sistemin tatimor. Ngjashëm me kompanitë tjera që veprojnë në sektorin e TIK, 3CIS kishte probleme me specifikimin e veprimtarisë afariste në bazë të kodeve të ARBK. Për më tepër, labiliteti politik në Kosovë dhe vështirësitë me shërbimet e sigurimit të përgjegjësisë përbënin probleme shtesë për të. Kontratat dhe garancitë, siç janë Sigurimi i Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë dhe Sigurimi i Përgjegjësisë së Produktit, duhej të realizoheshin jashtë Kosovës. Brengë tjetër e 3CIS ishte (dhe vazhdon të jetë) sistemi arsimor, pasi që të diplomuar-it në universitete nuk posedojnë shkathtësitë e domosdoshme për të punuar në treg. Prandaj, siç ceket më sipër, 3CIS është dashur të investojë një sasi të konsiderueshme të parave dhe kohës në ndërtimin e kapaciteteve të domosdoshme profesionale, përmes trajnimeve përbrenda organizatës dhe certifikimeve profesionale. Çështje tjera ishin ato që kanë të bëjnë me sistemin tatimor dhe eksportet. 3CIS eksporton të gjitha shërbimet e veta dhe kohë pas kohe përballeshin me probleme me ATK, e cila nganjëherë i tatonte shërbimet në fjalë. Përveç kësaj, kjo kompani "ndëshkohej" nga doganat pasi që detyrohet të paguajë pagesat doganore për pajisjet dhe pajimet e importuara, të cilat ajo i përdorë për t'i trajnuar punonjësit dhe për të kryer simulime, hulumtime e veprimtari zhvillimore.

3. Kontributi dhe prodhimi i kompanive/industrisë

3.1. Lënda e parë dhe materialet e ndërmjetme

Kontributi në industrinë e TIK kategorizohet si kosto për lëndë të parë dhe materiale të ndërmjetme, energjia dhe komunalitë tjera, si dhe për paga për punonjësit.

Për lëndë të parë dhe produkte përcjellëse, kostot mesatare mujore të raportuara nga kompanitë e sektorit të KPA-QPK gjatë vitit 2012 arrinin €23,172.⁹ Marrë parasysh se kompanitë e TIK nuk përdorin shumë lëndë të parë në krahasim me industritë tjera, kjo shumë mund të konsiderohet paksa e pakuptueshme. Megjithatë, bizneset në këtë industri i klasifikojnë edhe disa pajisje dhe pajime të tyre të cilat i rishesin si produkte përcjellëse, dhe të njëjtat i shesin për shuma më të larta se sa vlera që ato ua shtojnë shërbimeve të caktuara, andaj mund të ndodhë që shuma reale të jetë më e lartë.

Tabela 8: Kostoja mesatare për lëndë të parë dhe produkte përcjellëse, për kompani (në vitin 2012)

	Mujore	Vjetore
Kostoja e kontributit	€23,171.67	€278,060.00

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

3.2. Energjia elektrike dhe komunalitë

Për vitin 2012, kostoja mesatare për kompani për energji elektrike, ujë, derivate dhe shpenzime tjera të ngjashme është paraqitur në vijim, e ndarë për muaj dhe për vit (Tabela 9).

Tabela 9: Kostoja mesatare mujore dhe vjetore për firmë (në vitin 2012)


	Mujore	Vjetore
Energji elektrike	€ 192.50	€ 2,310.00
Ujë	€ 33.37	€ 400.40
Derivate	€ 2,393.33	€ 28,720.00
Tjera	€ 700.00	€ 8,400.00
GJITHSEJ	€ 3,319.20	€ 39,830.40

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

9. Për shkak të normës së ulët të përgjigjes sa u përket lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme (26%), këto të dhëna duhet të shqyrtohen me rezerva.

Marrë parasysh të gjitha kostot, mesatarisht kostoja e lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme është më e lartë se kostot tjera individualisht (67.7%), ndërsa kostot e pagës radhiten në vend të dytë (22.6%). Gjithsej, lënda e parë, produktet e ndërmjetme dhe pagat përbëjnë 90.3% të kontributeve të përgjithshme të këtyre bizneseve në vitin 2012.

Figura 4: Ndarja e kostove të kontributeve: mesatarja për ndërmarrje për vitin 2012




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

3.3. Struktura e materialeve të ndërmjetme (lokale kundrejt të huaja)

Në sektorin e KPA-QPK ekzistojnë disa akterë kyçë në zinxhirin e furnizimit në këtë industri, dhe në këtë anketë nga kompanitë është kërkuar që të ndajnë vlerën e përgjithshme të kontributeve të tyre sipas llojit dhe sipas furnizuesit. Siç paraqitet në figurën e mëposhtme (Figura 5), 29.4% prodhojnë produktet e tyre apo materialet e ndërmjetme brenda ndërmarrjeve të tyre. Për shkak të natyrës së këtij sektori, lënda e parë dhe materialet e ndërmjetme konsiderohen hardueri, softueri, pajisjet dhe veglat që kompanitë i shfrytëzojnë për të zhvilluar apo rishitur produktet e veta dhe shërbimet me vlerë të shtuar. Për më tepër, ne mund të shohim nga diagami në vijim se 58.9% të kompanive raportojnë se i prodhojnë kontributet e tyre apo të njëjtat i blejnë brenda vendit, ndërsa pak mbi 41% të tyre i importojnë ato nga prodhuesit apo tregtarët ndërkombëtarë.


Figura 5: Vlera e gjithmbarshme e lëndës së parë dhe materialeve të ndërmjetme, sipas llojit të furnizuesit



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Nëse e shqyrtojmë edhe më tej miksturën e kontributeve të vendit¹⁰ mund të vërejmë se shumica e kompanive (66.7%) përdorin vetëm kontribute të prodhuara nga to gjatë prodhimit të produktit përfundimtar. Ky nivel i lartë i kontributeve nuk është befasisht nëse kemi parasysh se shumica e kontributeve në fjalë mund të jenë pako softuerike dhe licenca të cilat janë të prodhuara enkas për përdoruesit e tyre dhe që shfrytëzohen për përpunim të mëtejshëm dhe veprimtari tjera me vlerë të shtuar.


Figura 6: Pjesa e kontributeve vendore



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kontribute të ngjashme përdoren edhe nga prodhuesit dhe tregtarët vendorë (Figura 7). Mesatarisht, 66.7% të bizneseve blejnë tërë lëndë e parë dhe materialet e ndërmjetme nga prodhuesit vendorë, ndërsa të tjerët sigurojnë vetëm gjysmën e kontributeve nga ta. Në anën tjetër, 33.3% të kompanive plotësojnë nevojat e tyre për lëndë të parë dhe materiale të ndërmjetme nga tregtarët lokalë.

Figura 7: Pjesa e kontributeve nga prodhuesit dhe tregtarët vendorë




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

10. Lëndë e parë apo materiale të ndërmjetme.

Kompanitë që importojnë nga prodhuesit dhe tregtarët ndërkombëtarë kanë blerje më të llojlojshme. Mesatarisht pesëdhjetë për qind të kompanive blejnë 30% të kontributeve të tyre nga prodhuesit ndërkombëtarë, ndërsa vetëm njëzet për qind i blejnë të gjitha kontributet e tyre kësisoj. Asnjë nga kompanitë e anketuara nuk i siguron të gjitha kontributet përmes tregtarëve ndërkombëtarë, por pesëdhjetë për qind importojnë 70% të kontributeve të tyre.

Figura 8: Pjesa e kontributeve nga prodhuesit dhe tregtarët ndërkombëtarë




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

3.4. Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe vlera e prodhimit

Të dhënat e anketës dëshmojnë se kompanitë e sektorit të TIK perceptojnë se kapacitetet e veta i shfrytëzojnë në mënyrë mjaft joefikase:¹¹ kompanitë e anketuara kanë raportuar se mesatarisht shfrytëzojnë vetëm gjysmën e kapaciteteve të veta. Kjo shifër ngritë brenga lidhur me mundësinë që kompanitë të kenë investuar së tepërmi apo që të ketë mungesë të kërkesës për produktet dhe shërbimet e këtyre kompanive në treg. Sidoqoftë, nëse krahasojmë nivelin e shfrytëzimit të kapaciteteve në vitin 2011 dhe 2012 do të vërejmë një rritje pozitive prej 11 për qind (24%) në shfrytëzimin e kapaciteteve të kompanive (Figura 9).

Figura 9: Shfrytëzimi i kapaciteteve




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Në anën tjetër, nëse krahasojmë vlerën e produktit të prodhuar nga kompanitë e anketuara, ajo nuk pasqyron drejtpërdrejt këtë ngritje të nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve. Edhe pse dallimet mes vitit 2011 dhe 2012 nuk janë të mëdha, numri i bizneseve që ka realizuar prodhimtari me vlerë mes €25,000 dhe €500,000 është zvogëluar për 14.4%. Ky ishte ndryshimi më i madh negativ prej 5.4 pikë përqindjeje

11. Shfrytëzimi i tërë makinerisë ekzistuese (të instaluar) në kompani.

për produktet e prodhuara (Figura 10). Ndërsa, numri i atyre që kanë realizuar prodhimin prej €10,000 apo më të ulët në vit është shtuar me 8.0 pikë përqindjeje mes vitit 2011 dhe 2012.


Figura 10: Krahasimi i vlerave vjetore të prodhimit në vitin 2011 dhe 2012, sipas kompanisë¹²



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Siç ilustron më poshtë (Figura 11), është me interes të përmendet se gjatë vitit 2012 numri i firmave që kanë realizuar prodhim deri në €10,000 (37.5%) ishte i njëjti me numrin e atyre që kanë realizuar prodhim mes €250,001-€500,000 në vitin 2012 (37.5%).

Figura 11: Vlera vjetore e prodhimit (për vitin 2012)



Burimi: Anketa e UNDP, 2013


12. Asnjë nga bizneset nuk ka raportuar vlerë vjetore të prodhimit të realizuar nën kategoritë €10,001-€25,000 dhe €50,001-€100,000.

4. Tregjet

4.1. Qarkullimi

Në përgjithësi, 62% e bizneseve kanë refuzuar përgjigjen në këtë pyetje. Duke qenë të vetëdijshëm për madhësinë e sektorit në fjalë, ne duhet të jemi të kujdesshëm dhe t'i shqyrtojmë këto gjetje me rezervë. Sidoqoftë, për ato biznese që i janë përgjigjur pyetjes në fjalë vërehet se ekzistojnë dy intervale kryesore në të cilat shumica e kompanive bëjnë pjesë. Dyzetekatër për qind të kompanive të anketuara kanë deklaruar se kanë gjeneruar qarkullim vjetor prej €250,001-€500,000, ndërsa në vend të dytë radhiten kompanitë që kanë raportuar gjenerim të qarkullimit vjetor më të ulët se €10,000.


Figura 12: Qarkullimi vjetor për vitin 2012¹³



Me rastin e krahasimit të shifrave të vitit 2012 me ato të vitit 2011, vërehen ndryshimet kryesore në intervalin më të ulët (+9.7 pikë përqindjeje) dhe intervalin më të lartë (-5.6 pikë përqindjeje) (Figura 13). Kjo është në korelacion të ngushtë me vlerën vjetore të prodhimit për kompani, ndërsa në bazë të këtyre të dhënave, duket se kompanitë e kësaj industrie kanë realizuar të hyra më të ulëta në vitin 2012 se sa në vitin 2011.

13. Asnjë nga bizneset nuk ka raportuar qarkullim vjetor mes €100,001-€250,000 për vitin 2012.

Figura 13: Krahësim i qarkullimit vjetor të vitit 2011 dhe 2012¹⁴



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

4.2. Produktet, shërbimet dhe kanalet lokale

Mes kompanive KPA-QPK që kanë deklaruar shitje në vend, rreth 70% kanë deklaruar se 100% të produkteve dhe shërbimeve të tyre përfundimtare shiten në Kosovë (Tabela 10). Në anën tjetër, 13% të bizneseve të anketuara kanë raportuar se shesin mesatarisht 66.7% të produkteve të ndërmjetme dhe shërbimeve të tyre brenda vendit.


Tabela 10: Shitjet në vend: produkte dhe shërbime

	% të kompanive	Shitjet (%)
Produkte dhe shërbime finale	69.6%	100.0%
Produkte dhe shërbime të ndërmjetme	13.0%	66.7%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Gjatë anketës bizneset gjithashtu u pyetën nëse shitjet e tyre i bëjnë tek lloje të ndryshme blerësish vendorë. Gati 52.6% të kompanive thanë se produktet e tyre ua shesin distributorëve/shitësve me shumicë dhe shitësve me pakicë. Vetëm 11.1% të kompanive kanë raportuar se produktet dhe shërbimet ua shesin kompanive tjera të cilat i përpunojnë ato më tej, ndërsa 94.4% kanë raportuar se produktet e tyre ua shesin përdoruesve fundorë (Figura 14).

Figura 14: Ndarja e blerësve vendorë të cilëve u shesin kompanitë




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

14. Asnjë nga bizneset nuk ka raportuar qarkullim vjetor mes €100,001-€250,000 për vitin 2012.

Duke vlerësuar pjesën e shitjeve të kompanive që shesin produktet e tyre në vend vërejmë se 45% e produkteve dhe shërbimeve u destinohen përdoruesve fundorë. Njëmbëdhjetë për qind i vëllimit të gjithmbarshëm të shitjes përbëhet nga shitjet tek kompanitë tjera që i përdorin këto produkte apo shërbime si kontribute në proceset e tyre prodhuese. Megjithatë, distributorët/shitësit me shumicë konsiderohen si blerës të rëndësishëm në këtë zinxhir të vlerave, pasi që kompanitë realizojnë 26 për qind të shitjeve tek ta.


Figura 15: Pjesa e shitjeve të gjithmbarshme në vend, sipas blerësit (në vitin 2012)



4.3. Shitjet vendore kundrejt shitjeve jashtë vendit


Në përgjithësi, mesatarisht 95% të kompanive shesin së paku 50% të produkteve dhe shërbimeve të tyre në tregun vendor. Gjatë krahasimit të shitjeve të drejtpërdrejta në vend dhe jashtë vendit, kompanitë e intervistuar deklaruan se 75% prej tyre shesin mbi 90% të produkteve dhe shërbimeve në vend (Figura 16). Kur të anketuarit u pyetën për shitjet e tyre ndërkombëtare u arritën rezultate pak a shumë të kundërta. Në këtë rast 25% të fundit raportuan se shesin mes 0% dhe 49% të produkteve dhe shërbimeve të tyre në tregjet ndërkombëtare.

Figura 16: Shitjet në vend gjatë vitit 2012



Sipas kompanive të anketuara nuk ka ndonjë ndryshim madhor evident mes të dhënave të vitit 2011 me ato të vitit 2012 për sa u përket shitjeve vendore dhe ndërkombëtare, të cilat kanë mbetur relativisht stabile (Figura 17). Megjithatë, siç do të shtjellohet në kaptinën në vijim, në bazë të të dhënave të Doganave të Kosovës, gjatë kësaj periudhe ka pasur ndryshim të theksuar të eksportit, gjë që vë në pah se ekziston një mospërputhje mes asaj që raportohet nga kompanitë në anketë dhe asaj që kompanitë në realitet regjistrojnë pranë Doganave të Kosovës.

Figura 17: Shitjet ndërkombëtare, në vitet 2011 dhe 2012




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

4.4. Eksportet

Kodet doganore brenda të dhënave të Doganave të Kosovës nuk janë gjithmonë eksplicite dhe nuk mund të identifikohen me lehtësi nga sektori i KPA-QPK, prandaj, identifikimi i saktë i importeve dhe eksporteve të këtij sektori është mjaft i vështirë. Në përgjithësi, industria e TIK është në deficit tregtar prej -€50.5 milion, dhe kjo kra-hasuar me vitin 2010 shënon ndryshim pozitiv prej +1.68%. Brenda të njëjtës peri-udhë (2010-2012) importet kanë qenë pothuajse të pandryshuara, ndërsa eksportet kanë rënë në mënyrë drastike për 57.9%.

Figura 18: Eksportet, importet dhe bilanci tregtar (në mijë)



Burimi: Doganat e Kosovës, 2013

Nga kompanitë eksportuese të sektorit KPA-QPK që janë anketuar me këtë rast, vetëm 30.4% deklaruan se i eksportojnë të gjitha produktet dhe shërbimet e tyre (Tabela 11). Kjo ndërlidhet me kaptinën paraprake në të cilën 75% të bizneseve kanë deklaruar se i shesin 90% të produkteve dhe shërbimeve të tyre brenda vendit. Përveç kësaj, vetëm 4.3% të bizneseve kanë raportuar se eksportojnë produkte dhe shërbime të ndërmjetme. Përveç kësaj, vetëm 4.3% të bizneseve kanë raportuar se eksportojnë produkte dhe shërbime të ndërmjetme. Pjesa e mbetur (65.3%) nuk i janë përgjigjur pyetjes lidhur me eksportimin nën këto dy kategori.


Tabela 11: Eksportet: produktet dhe shërbimet

	% të kompanive	Produkte (%)
Produkte dhe shërbime finale	30.4%	100.0%
Produkte dhe shërbime të ndërmjetme	4.3%	100.0%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Kompanitë e anketuara kanë deklaruar se kryesisht eksportojnë tek shitësit me pakicë (71.4%) ndërsa vetëm 30.4% të eksportit bëhet tek përdoruesit fundor po konsumatorëve përfundimtarë (Figura 19). Në anën tjetër, distributorët apo shitësit me shumicë janë po ashtu blerës relativisht të mëdhenj, duke qenë se 43% të firmave të anketuara kanë deklaruar se produktet apo shërbimet e tyre ua shesin të njëjtëve.


Figura 19: Ndarja e blerësve të huaj të cilëve u shet kompania



Burimi: Anketa e UNDP, 2013


Në kuptim të shitjes së përgjithshme jashtë vendit, 41% të kompanive thonë se eksportojnë drejtpërdrejtë tek përdoruesit fundorë, ndërsa vetëm 7% ndërlidhen me kompani tjera që i përdorin këto produkte apo shërbime për përpunim të mëtejshëm (Figura 20). Distributorët/shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë mbulojnë 52% të tërë eksportit. Prandaj, ata luajnë rol të rëndësishëm në zinxhirin e vlerave dhe ndikojnë në eksportimin e produkteve dhe shërbimeve shumë më shumë se sa blerësit në tregun vendor.

Figura 20: Ndarja e shitjeve të përgjithshme jashtë vendit, sipas blerësit (për vitin 2012)




Produktet dhe shërbimet kryesore që eksportohen nga kompanitë e KPA/QPK janë kompjuterët dhe pajisjet tjera relevante të TI, produktet softuerike (për kompjuterë, internet, pajisje mobile) dhe shërbimet tjera të ndërlidhura (Figura 21). Produktet softuerike përbëjnë 50% të produkteve të eksportuara, ndërsa pajisjet harduerike vetëm 33% të shumës së gjithmbarshme. Me gjithë eksportimin e kompjuterëve dhe pajisjeve tjera, ato jo domosdoshmërisht prodhohen në Kosovë.

Figura 21: Produktet dhe shërbimet e eksportuara



Për më tepër, nga bizneset është kërkuar që të raportojnë mbi shitjet e tyre jashtë vendit në bazë të vëllimit të përgjithshëm të produkteve dhe shërbimeve që i eksportojnë nëpër destinacione të ndryshme. Në bazë të të dhënave për eksportin e gjithmbarshëm të tërë vëllimit të eksportuar në tregje të huaja, destinacioni kryesor i mallrave dhe shërbimeve të sektorit të TIK në Kosovë janë shtetet evropiane (91% të kompanive), ndërsa vetëm 9% të kompanive kanë raportuar eksporte në Kanada dhe Shtete të Bashkuara. Përbrenda Evropës, shtetet e Ballkanit pranojnë 67% të eksporteve, prej të cilave vetëm Shqipëria merr 37%. Nga shtetet e Evropës perëndimore vlen të përmendet Gjermania, e cila pranon 14% të eksportit të gjithmbarshëm.

Figura 22: Tregjet e eksportit



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Shumica e bizneseve që eksportojnë në këto shtete/rajone kanë filluar veprimtarinë e tyre eksportuese mes viteve 2006 dhe 2010. Vetëm 14.3% kanë filluar eksportimin gjatë periudhës 2000 - 2005, ndërsa 28.6% kanë filluar pas vitit 2010. Mes kompanive të anketuara, 38% të kompanive duan të eksportojnë, por thonë se përballen me pengesa të shumta.

Disa prej pengesave të identifikuar të eksportimit janë karakterizuar gjatë anketimit si pengesa të jashtme dhe të brendshme. Nga të intervistuarit është kërkuar t'i radhisin të gjitha pengesat e përmendura në listë prej 0 deri në 10. Tabela në vijim paraqet listën e pengesave dhe radhitjen e tyre sipas respondentëve. Për shembull, barrierë kryesore u cilësua të jetë *marrëdhëniet politike me shtetin ku eksportohet* (Tabela 12).

Tabela 12: Pengesat e jashtme të eksportit

Pengesa	Intensiteti
Marrëdhëniet politike me shtetin ku eksportohet	55
Mundësitë e kufizuara të afarizmit dhe rrjetëzimit	53
Infrastruktura me shtetet eksportuese dhe të transitit	53
Mosefikasiteti i agjentëve doganorë/ndërmjetësuesve	50
Mosefikasiteti i administratës doganore të shteteve të transitit dhe eksportit	46
Kostoja e lartë e garancive bankare	44
Mungesa e kredive eksportuese	40
Procedurat ekzekutive doganore	37
Standardet ndërkombëtare të cilësisë	35
Shpenzimet e transportit	30

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Më tej, *paaftësia për të krijuar marrëdhënie me partnerë dhe biznese të huaja* u radhit si pengesa kryesore e brendshme, duke vënë në dukje rëndësinë e rrjetëzimit dhe themelimit të shoqatave të ndryshme mes Kosovës dhe shteteve tjera për mundësimin e eksporteve (Tabela 13).

Tabela 13: Pengesat e brendshme të eksportit

Pengesa	Intensiteti
Paaftësia për të krijuar marrëdhënie me partnerë dhe biznese të huaja	34
Struktura joefikase menaxhuese	31
Paaftësia për të tregtuar dhe paraqitur produktet në mënyrë efektive	31
Mungesa e vullnetit të pronarit për zgjerim	27
Paaftësia për të trajnuar punonjësit apo për t'i jetësuar gjërat e mësuara në trajnime	20
Paaftësia për të përfunduar procesin e certifikimit për standardet e cilësisë	19

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rubrika 1: Rregulloret tregtare

Disa nga rregulloret dhe proceset e Kosovës për tregtim tejkuftar janë minimizuar dhe optimizuar kohëve të fundit. Për shembull, në bazë të Raportit për Lehtësinë e Zhvillimit të Afarizmit të publikuar në vitin 2014, rreth 25% të shpenzimeve të eksportit kanë shënuar rënie në krahasim me vitin 2012. Përveç kësaj, nga viti 2012 në vitin 2013 Kosova është ngritur për tri pozita në radhitjen e përgjithshme sa i përket lehtësisë së tregtimit tejkuftar, nga pozita 124 në pozitën 121. (TWB, 2013) (TWB, 2014).

Rregulloret tregtare: importet

Sipas raportit të Bankës Botërore për lehtësinë e zhvillimit të afarizmit në Kosovë (eng. Doing Business Report), mesatarisht realizimi i të gjitha procedurave e domosdoshme për importimin e mallrave dhe produkteve mund të merr deri në 15 ditë¹⁵ dhe kërkon paraqitjen e tetë dokumenteve të ndryshme.¹⁶ Megjithatë, kjo nuk aplikohet për importet tipike të produkteve të TIK, pasi që për to nevojiten vetëm tri dokumente të përgjithshme, të cilat mund të nxirren për një periudhë shumë më të shkurtër:

- dokumenti individual administrativ (d.m.th. deklarata unike doganore)
- fatura komerciale
- Certifikata e Origjinës¹⁷

15. <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo/#trading-across-borders>

16. Këtu përfshihen edhe procedurat nga porti detar në Shqipëri.

17. Përfshijet shtetet me të cilat Kosova ka Marrëveshje të Tregtisë së Lirë, apo me të cilat ka marrëveshje tjetër që përmban përjashtime në bazë të rregullave të origjinës.

Aktualisht, për produktet dhe shërbimet e TIK nuk zbatohet kurrfarë lehtësire doganore dhe kjo me këtë fakt komuniteti i TIK nuk është i kënaqur pasi që “shtetet tjera të rajonit kanë... zero taksa importuese për produktet teknologjike (TIK)... në krahasim me dhjetë për qind taksa doganore për produktet teknologjike që aplikohet në Kosovë” (UNDP, 2012). Pas shumë vitesh lobimi, Ministria e Financave e Kosovës ka përpiluar një pro-jektligj të ri mbi mallrat e liruar nga taksa doganore, i cili u miratua nga Kuvendi në dhjetor të vitit 2013¹⁸. Megjithatë, ky ligj liron nga taksat doganore vetëm disa produkte të caktuara të TIK.

Rregulloret tregtare: Eksportet

Sa u përket eksporteve, bizneset kosovare obligohen të paraqesin vetëm dy dokumente, e i njëjti rast është për kompanitë e sektorit TIK-KPA-QPK:

- dokumentin administrativ individual (d.m.th. deklaratën unike doganore)
- faturën komerciale

Rubrika 2: Tregtia e lirë

Kosova ka regjim të tregtisë të lirë dhe disa marrëveshje tregtare të cilat i kontribuojnë zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare në Kosovë (APIK-MTI, 2010)¹⁹. Megjithatë, për mo-mentin nuk ekziston asnjë marrëveshje specifike lidhur me produktet apo shërbimet që ndërlidhen me TIK-KPA-QPK.

CEFTA

Aktualisht sektori i TIK-KPA-QPK në Kosovë nuk gëzon kurrfarë privilegji apo kufizimi sht-esë nga marrëveshja e CEFTA-s. Megjithatë, ka pasur diskutime lidhur me një marrëveshje për të liberalizuar shërbimet mes shteteve anëtare të CEFTA-s.²⁰ Është po ashtu e rëndësishme të theksohet se Kosova ka qëndrimin më liberal brenda CEFTA-s sa i përket punësimit afatshkurtër të shtetasve të huaj.

EU-ATP

Në bazë të Regjimit Preferencial Tregtar Autonom të BE-së (Rezoluta e Këshillit të BE-së 2007/2000), Kosova gëzon tregtim joreciprok pa doganë me tregun e BE-së dhe “në vitin 2012 eksporti i përgjithshëm në BE arrinte 107.4 milionë, ndërsa importi 978.1 milionë.”²¹ Gjatë periudhës 2009-2010, një numër i konsiderueshëm i kompanive të sektorit TIK-KPA-QPK kanë eksportuar shërbime në Zvicër, Austri dhe Gjermani, kryesisht në formë të qendrave të thirrjes dhe përkrahjes së konsumatorëve (APIK-MTI, 2010). Në vitet 2012-2013 edhe pse nuk pa pasur ndonjë ndryshim të madh të këtij numri, shërbimet kanë mi-gruar drejt produkteve me vlerë më të lartë, siç janë përkrahja dhe mirëmbajtja teknike, web-dizajnet dhe zhvillimi, si dhe inxhinieria softuerike. Megjithatë, shumica e vendeve të BE-së janë më të hapura ndaj kontraktimit të shërbimeve në shtetet anëtare të BE+EF-TA, ndërsa Kosova ende nuk është pjesë e listës BE+EFTA (CBI, 2013).

18. [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Mallrat%20e%20Liruara%20nga%20tatimi%20do-ganor%20\(anglisht\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Mallrat%20e%20Liruara%20nga%20tatimi%20do-ganor%20(anglisht).pdf)

19. http://www.eciks.org/english/publications/investing_in_kosovo_2010 & <http://www.cefta.int>

20. <http://siteresources.worldbank.org/ECAEXT/Resources/BarrierstoTradeinServicesintheCEFTARegion.pdf>

21. <http://www.invest-ks.org/en/Why-Kosovo>

Tregu i SHBA-ve

Kosova gëzon privilegjet e Sistemit të Përgjithësuar Preferencial (GSP) me qeverinë e SHBA-ve, sa i përket qasjes në tregun e SHBA-ve të liruar nga obligimet doganore²². Megjithatë, shërbimet dhe produktet e sektorit të TIK-KPA-QPK nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja e tregtisë së lirë Kosovë - Turqi

Sa i përket sektorit të TIK-AKP-QPK, një numër i vogël i produkteve të prodhuara në Turqi importohen në Kosovë (apo anasjelltas), kështu që kjo marrëveshje pritet të ketë ndikim fare të vogël në këtë sektor. Sipas kësaj marrëveshjeje nga obligimet doganore lirohen kryesisht produktet industriale dhe bujqësore, ndërsa produktet dhe shërbimet që ndërlidhen me sektorin e TIK nuk përmenden në mënyrë të veçantë.

Tregtia me Japoninë dhe Norvegjinë

Aktualisht nuk ekzistojnë marrëveshje të tregtisë së lirë me Japoninë apo Norvegjinë, megjithatë, "me këto shtete në fuqi janë vetëm disa kufizime cilësore dhe sasiore që ndërlidhen me një numër shumë të kufizuar të mallrave."²³ Për më tepër, Norvegjia konsiderohet partner i sektorit të TIK-KPA-QPK. Ambasada norvegjeze, në bashkërendim me Crimson Capital dhe STIKK, ka krijuar disa mundësi për kompanitë e reja dhe kompanitë e sektorit të TIK në Kosovë në përgjithësi.

22. <http://www.ustr.gov/trade-topics/trade-development/preference-programs/generalized-system-preferences-gsp/gsp-program-i-0>

23. <http://www.invest-ks.org/en/Why-Kosovo>

5. Punësimi dhe burimet

njerëzore në kompani/industri

5.1. Numri i të punësuarve dhe kostoja e punës

Marrë parasysh se rreth 20% të 120 bizneseve aktive në sektorin e TIK supozohet se merren me veprimtari të KPA-QPK (sipas anketës së UNDP), supozohet se sektori i TIK-KPA-QPK në vitin 2012 punësonte 334 persona . Në vazhdimësi, nëse konsiderojmë të dhënat nga anketa e fundit e STIKK (Berisha & Ilazi, 2014), sektori i TIK në përgjithësi supozohet se në vitin 2012 punësonte 1,848 persona, ndërsa në vitin 2013 - 1716 persona (Tabela 14).²⁴

Tabela 14: Numri i të punësuarve

Viti	Anketa e UNDP TIK-KPA-QPK	Anketa e STIKK - TIK
2011	321 të punësuar	
2012	334 të punësuar	1,848 të punësuar
2013		1,716 të punësuar

Burimi: Anketa e UNDP, 2013; STIKK, 2013

Në anën tjetër, paga mesatare mujore në kompanitë e KPA-QPK në vitin 2012 ishte €7,721.43, që bën që kostoja mesatare vjetore për paga për kompani të arrijë në €92,657.14 (Tabela 15). Kostot për paga konsiderohen si kostot më të mëdha të kompanive të KPA-QPK. Ndërsa paga mesatare e të punësuarve në industrinë e TIK ishte €409²⁵, në sektorin e KPA ajo arrinte rreth €555²⁶.

Tabela 15: Kostoja mesatare e pagave në këtë sektor, për vitin 2012

Periudha	Kosto
Mujore	€7,721.43
Vjetore	€92,657.14

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

24. Numri mesatar i të punësuarve për kompani në vitin 2012 ishte 15.4, ndërsa në vitin 2013 është 14.3; Analiza e Mangësisë së Shkathtësive, 2013, STIKK - EYE (www.stikk-ks.org/2013)


25. Po aty.

26. Zakonisht kompanitë e mëdha paguajnë paga shumë më të larta se sa bizneset mikro dhe të vogla, e marrë parasysh madhësinë e këtij sektori dhe të mostrës, dallimet e mëdha përbrenda mostrës ndikojnë në vlerën e përgjithshme mesatare të pagës. Prandaj, ky fakt duhet marrë parasysh gjatë çfarëdo reference ndaj këtyre informatave.

5.2. Struktura e arsimimit, trajnimit dhe zhvillimit


Fuqia punëtore e sektorit të TIK-KPA-QPK mund të konsiderohet si tejet e arsimuar dhe shumë e kualifikuar, nëse arsimimi formal përbën faktor përcaktues të kësaj. Mes respondentëve të anketuar, 50% të bizneseve kanë konfirmuar se të punësuarit e tyre kanë tituj universitar, 24% kanë të kryera studimet e shkallës së tretë, ndërsa 26% të tjerë kanë arsimim të mesëm (Figura 23).

Figura 23: Struktura e arsimimit brenda sektorit



Diagrami në vijim paraqet ndarjen sipas nivelit të arsimit të të punësuarve në sektorin e TIK dhe sipas gjinive, e sipas të njëjtit përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore me diplomë universitare apo të shkallës së tretë është paksa më e lartë (77.2%) se sa përqindja e meshkujve me të njëjtin arsimim (71.4%).

Figura 24: Struktura e arsimit: burra dhe gra



Në përgjithësi, kompanitë e sektorit të TIK-KPA-QPK 68% të punonjësve i punësojnë me orar të plotë pune, 25% me gjysmë orari ndërsa 7% për punë sezonale (Tabela 16).

Tabela 16: Lloji i punësimit

Lloji i punësimit	Përqindja(%)
Të punësuar me orar të plotë	67.9%
Të punësuar me gjysmë orari	25.1%
Të punësuar sezonale	7.0%

Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sa i përket trajnimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të stafit, 43% të kompanive të sektorit KPA-QPK deklaruan se ofrojnë trajnime në vend të punës. Për më tepër, 83% të të gjitha kompanive të sektorit të TIK ofrojnë dhe realizojnë trajnime të brendshme, ndërsa vetëm 11% prej tyre nuk e trajnojnë stafin fare (Tabela 17).

Tabela 17: Trajnimi i të punësuarve²⁷


Ku i trajniti të punësuarit tuaj?	TIK
Përbrenda kompanisë (mentorim, orientim, qendra të trajnimit profesional)	83%
Jashtë ndërmarrjes	4%
Nuk ofrohet trajnim	11%
Tjera, nuk e di	3%

Burimi: STIKK, 2013

5.3. Perceptimet e bizneseve lidhur me nivelin e përgatitjes së fuqisë punëtore

Perceptimi i bizneseve të intervistuar të sektorit KPA-QPK lidhur me nivelin e përgatitjes dhe aftësive të fuqisë punëtore është mjaft pozitiv, pasi që vetëm 19% të kompanive deklaruan se ka mungesë të fuqisë punëtore me përgatitje adekuate (29% ishin neutralë) (Figura 25).


Figura 25: Punonjësit me përgatitje adekuate



27. Kjo tabelë dhe përmbajtja e saj është vendosur këtu me pëlqim të STIKK (Analiza e Mangësisë së Shkathtësive, 2013, STIKK-EYE) – www.stikk-ks.org

Megjithatë, këto proporcione ndryshuan kur të njëjtat kompani u pyetën nëse sigurimi i kësaj fuqie punëtore është i kushtueshëm. Ndërsa respondentët neutralë nuk lëvizën shumë, 26% të bizneseve thanë se kjo është e vërtetë dhe 43% deklaruan se fuqia punëtore e kualifikuar nuk është e shtrenjtë (Figura 26).

Figura 26: A është e shtrenjtë fuqia punëtore me kualifikime adekuate





Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Përgjigje të ngjashme u dhanë edhe në pyetjen për të punësuarit me tituj universitarë (Figura 27).

Figura 27: Të punësuarit me tituj universitarë: disponueshmëria dhe kostoja

*Mungesë të të diplomuarve
në këtë sektor*



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se të punësuarit në këtë sektor i posedojnë të gjitha shkathtësitë e duhura dhe se nuk kanë nevojë për trajnim apo zhvillim të mëtejshëm. Tabela në vijim paraqet në mënyrë të detajuar shkathtësitë teknike dhe menaxheriale që sektorit të TIK i nevojiten më së shumti (Tabela 18).²⁸

28. Po aty.

Tabela 18: Shkathtësitë më të kërkuara teknike

Cilat nga këto <u>shkathtësi teknike</u> i nevojiten kompanisë suaj më së shumti?	
Rrjetet e avancuara (CCNP)	37%
Programimi Server-Klient (Java, C++)	32%
Administrimi i bazave të të dhënave (MS SQL, Oracle, MySQL)	31%
Administrimi i sistemit (MS Windows Server, Exchange Server)	28%
Web-programimi (PHP, ASP, Perl, Python)	22%
Web-dizajni (Html, JavaScript, photo editing skills)	17%
Shkathtësitë teknike bazike (ECDL, Cisco IT Essentials 1)	8%
Administratorët e sistemeve Linux	8%
Njohuritë bazike të rrjeteve kompjuterike (CCNA)	6%

Burimi: STIKK, 2013

Në anën tjetër, shkathtësitë më të nevojshme në kuptim të menaxhimit janë menaxhimi i shitjeve, projekteve dhe marketingut (Tabela 19).

Tabela 19: Shkathtësitë më të kërkuara menaxheriale

Cilat nga këto <u>shkathtësi menaxheriale</u> i nevojiten kompanisë suaj më së shumti?	
Menaxhimi i shitjeve	45%
Menaxhimi i projekteve	35%
Menaxhimi i marketingut	29%
Menaxhimi i kontratave	22%
Analizat afariste	20%
Menaxhimi financiar	3%
Menaxhimi i burimeve njerëzore	3%

Burimi: STIKK, 2013

Për shkak të natyrës së këtij sektori dhe dinamikave të tij, kërkesa për shkathtësi teknike është gjithmonë e lartë. Teknologjitë dhe platformat e ndryshme në dispozicion e bëjnë përcjelljen e tyre më sfiduese edhe për kompanitë edhe për fuqinë punëtore të angazhuar në to, prandaj investimi në fitimin e shkathtësive të reja teknike është gjithmonë në fokusin e tyre. Megjithatë, shkathtësitë, siç janë për shembull menaxhimi i shitjeve, projekteve dhe marketingut, janë lënë anash apo mbase edhe janë injoruar fare pa ndonjë ndikim të theksuar. Me rritjen dhe ngritjen e përvojës së kompanive dhe klientëve të tyre, ngritja e nivelit të shkathtësive edhe në këto sfera do të jetë e domosdoshme sepse do t'ju ndihmojë atyre në zgjidhjen e problemeve më komplekse dhe në sigurimin e shërbimeve më të vlefshme për klientët e tyre.

Rubrika 4: Rregullimi i punës në Kosovë, nga këndvështrimi i kësaj industrie

Kosova ka një treg tejet fleksibil të punës me norma të ulëta tatimore dhe me pak rregullime strikte sa i përket punësimit dhe largimit nga puna të punonjësve. Sistemi i tatimit në të ardhura personale është sistem tatimor progresiv dhe shkon mes 0 dhe 10 për qind. Përveç kësaj, punëdhënësi paguan vetëm edhe 5 për qind për kontribute pensionale të punonjësve, ndërsa punonjësit paguajnë 5% tjera. Që nga viti 2011 Kosova ka përcaktuar si pagë minimale shumën prej €170, apo €130 për persona nën moshën 35 vjeçare. Që nga viti 2011, marrëdhënia e punësimit rregullohet me Ligjin e Punës (Nr. 03/L-212) i cili bazohet në konventa të ONP-së, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut të lirë të punës dhe ekonomisë së tregut. Që nga viti 2013, siguria dhe shëndeti në punë rregullohen me Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (nr. 04/L-161). Të gjitha bizneset dhe institucionet duhet t'i përmbahen këtij ligji.

Nuk ekzistojnë rregullore të posaçme të punës në sektorin e TIK.


6. Investimet e kompanive/industrisë dhe niveli teknologjik

Vlera aktuale e aseteve të kompanive të sektorit të KPA-QPK vështirë mund të përcaktohet pasi që vetëm 16% të kompanive kanë raportuar mbi vlerën reale të tokave dhe objekteve/ndërtesave të tyre. Megjithatë, në pyetjen lidhur me vlerën e teknologjisë dhe makinerisë së tyre, shumica dhanë përgjigje lidhur me vlerën e tyre në treg. Mesatarisht, kompanitë kanë raportuar se vlera e teknologjisë dhe makinerisë së përdorur në vitin 2011 ishte €19,486, ndërsa në vitin 2012 kjo vlerë ra në €10,946 (-43.8%). Duhet theksuar gjithashtu se 86% të kompanive të anketuara raportuan se janë pronare të teknologjisë dhe makinerisë që përdorin, ndërsa vetëm 14% të kompanive i marrin ato me qira.

6.1. Investimet e firmave, H&ZH dhe inovacionet, dhe prona industriale

Vlera e teknologjisë dhe makinerive të ndërmarrjeve si aset ka pësuar rënie prej -43.8% gjatë periudhës 2011-2012. Kjo mund të ketë ngjarë si rezultat i zhvlerësimit, shitjes, apo shfrytëzimit më të theksuar të aseteve, të cilat kanë mundur të ndikojnë në rritjen e lartpërmendur të nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve prej 10.9% gjatë të njëjtës periudhë. Kur kompanitë u pyetën nëse kanë investuar në produktet apo shërbimet e tyre gjatë vitit 2012, 31% raportuan se kanë investuar në softuer, aplikacione dhe shërbime (22%), apo në kompjuterë dhe pajisje (9%). Duhet theksuar se 69% të firmave kanë raportuar se gjatë vitit 2012 nuk kanë bërë kurrfarë investimesh (Figura 28).

Figura 28: Investimet në produkte dhe shërbime




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Sa u përket investimeve në hulumtime dhe zhvillim, vetëm 9% të kompanive kanë raportuar se kanë realizuar përmirësime të produkteve të tyre. Sa i përket marketingut dhe produkteve aktuale, 13% kanë deklaruar se kanë kryer përmirësime në proceset, produktet dhe sistemet aktuale të tyre.


Për më tepër, në pyetjen lidhur me nivelin aktual të mbrojtjes së pronës industriale, 50% deklaruan se niveli aktual është i kënaqshëm dhe nuk pengon zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja brenda kësaj industrie (Figura 29). Përdherisa 30% nuk kishin informata lidhur me efektet aktuale apo potenciale të këtij procesi, 20% vlerësonin se procesi është i ngadalshëm, i ndërlikuar dhe ndikon tek kompanitë.

Figura 29: Niveli aktual i ndikimit të patentimit industrial tek bizneset



Shtatëdhjetetë për qind të bizneseve që funksionojnë në sektorin e TIK-KPA-QPK kanë patente të regjistruara; vetëm 33% të tyre kanë raportuar se kanë regjistruar patente gjatë tri viteve të fundit (Figura 30).

Figura 30: Patente të regjistruara



Rubrika 5: Prona industriale dhe regjistrimi i patentave në Kosovë

Kjo industri ndikohet nga fuqia punëtore me njohuri adekuate dhe përgjegjëse për prodhimin e artefakteve dhe proceseve të reja dhe inovative, përmes veprimtarisë kreative të tyre. Sistemet softuerike përbëjnë pjesë të të gjitha proceseve afariste dhe çështjet më të ndjeshme në këtë kuptim janë të drejtat e pronës intelektuale dhe patentimi. Në Kosovë, ekzistojnë rregullore për mbrojtjen e pronës industriale, të cilat kategorizohen në dy kategori: Prona Industriale dhe të Drejtat e Autorit. E para përbëhet nga pjesa më e madhe e legjislacionit që rregullon patentat, markat tregtare, sekretet tregtare, dizajnin industrial, patentat e dizajnit, varietetet e impianteve dhe qarqet e integruara. Megjithatë, siç potencohet në doracakun e pronës intelektuale për zhvilluesit e softuerit, aktualisht “Kosova u ofron zhvilluesve të softuerit në Kosovë të gjitha format e mësipërme të mbrojtjes, përveç mbrojtjes së patentave.” (Plakolli, Kasumi, 2010).

Për më tepër, është e rëndësishë kyçe të theksohet se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka përpiluar disa dokumente relevante, siç janë Strategjia për të Drejtat e Pronës Intelektuale²⁹ dhe Plani i Veprimit për Implementimin e Strategjisë për të Drejtat e Pronës Intelektuale 2010-2014.³⁰ Përveç kësaj, Zyra e Pronës Industriale brenda MTI përbën autoritet kyç në administrimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me të drejtat intelektuale, ndërsa Zyra për të Drejtat Autoriale vazhdon të funksionojë si pjesë e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS). Sidoqoftë, përkundër ekzistimit të legjislacionit përkatës, institucionet duhet të punojnë më shumë në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fjalë. Siç potencohet në kaptinën mbi patentat «... problemi qëndron jo vetëm në zbatim, por edhe në paaftësinë e zhvilluesit fillestar për ta patentuar softuerin.» (UNDP, 2012, f. 87). Për më shumë informata lidhur me legjislacionin përkatës që rregullon pronën industriale dhe patentimin në Kosovë shih Shtojcën A.

29. www.mti-ks.org/repository/docs/STRATEGY_ON_INTELLECTUAL_PROPERTY_RIGHTS_eng.pdf

30. http://www.mti-ks.org/repository/docs/Plani_i_veprimi_Strategjin%20e%20prones%20intelektuale_2010-2014.pdf

7. Mjedisi afarist

7.1. Perceptimet lidhur me pengesat kryesore për zhvillimin e afarizmit

Kompanitë KPA-QPK kanë pasur rastin e shqyrtimit të një liste të gjatë të sfidave potenciale për zhvillimin e afarizmit në Kosovë. Gjatë anketës, nga kompanitë është kërkuar që çdo lloj pengese ta notojnë me një notë të caktuar dhe kështu ta paraqesin perceptimin e tyre lidhur me rëndësinë e pengesës në fjalë.³¹ Siç ilustron figura më poshtë, tri pengesat kryesore për zhvillimin e afarizmit në Kosovë për sektorin e TIK janë: i) niveli i taksave; ii) niveli i lartë i korrupsionit; dhe iii) efikasiteti i ulët i administratës tatimore (Figura 31). Qasja në toka dhe ndërtesa, vështirësitë ndërlidhur me marrjen e certifikatave të biznesit dhe qasja në infrastrukturë lokale (rrugë, shërbime të komunalive, etj.) konsiderohen si pengesa më të lehta për zhvillimin e afarizmit nga kompanitë e TIK.

Figura 31: Pengesat kryesore për zhvillimin e afarizmit në Kosovë³²

Pengesa	Radhitja
Niveli i taksave	I parë
Niveli i lartë i korrupsionit	I dytë
Efikasiteti i ulët i administratës tatimore	I tretë
Konkurrenca nga tregu i 'hirtë'	I katërt
Efikasiteti i ulët i doganave	I pestë
Efikasiteti i ulët i sistemit gjyqësor	I gjashtë
Mungesa dhe çmimi i energjisë elektrike	I shtatë
Mungesa e kërkesës nga tregu vendor	I tetë
Qasja në financim/kredi	I nëntë
Vështirësitë në sigurimin e makinerisë/pajisjeve	I dhjetë
Cilësia e lëndës së parë	I njëmbëdhjetë
Kostoja e materialeve prodhuese	I dymbëdhjetë
Kostoja e fuqisë punëtore (pagat e larta)	I trembëdhjetë
Punonjësit e pakualifikuar	I katërmëdhjetë
Infrastruktura lokale (rrugët, komunalitë, etj.)	I pesëmbëdhjetë
Vështirësitë në marrjen e certifikatave të biznesit	I gjashtëmbëdhjetë
Qasja në tokë dhe ndërtesa	I shtatëmbëdhjetë

Burimi: Anketa e UNDP, 2013


31. Respondentët i kanë notuar të gjitha pengesat me notë mes 0 dhe 17

32. Pengesat janë radhitur duke kalkuluar numrin e gjithmbarshëm të përgjigjeve për perceptimet e ndryshme.

7.2. Perceptimet e bizneseve lidhur me politikat tatimore dhe administratën tatimore

Në bazë të të dhënave të mësipërme, niveli i tatimit konsiderohet si pengesë kyçe për zhvillimin e afarizmit në Kosovë, ndërsa 62% të të anketuarve kanë deklaruar se tatimet janë të larta ose tejet të larta (Figura 32). Vetëm 5% të kompanive kanë thënë se tatimet janë tejet të ulëta


Figura 32: Niveli i tatimeve



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Edhe pse efikasiteti i ulët i administratës tatimore radhitej si pengesa e tretë për zhvillimin e afarizmit, kjo gjë nuk pasqyrohej në përgjigjet në pyetjet tjera të bëra në këtë anketë. Duke iu përgjigjur një pyetjeje tjetër të ndërlidhur, 75% të bizneseve thanë se administrata tatimore ka performancë orientimisht mesatare (sa i përket efikasitetit) ose efikase (Figura 33). Vetëm 15% të kompanive të anketuara thanë se administrata tatimore është tejet joefikase ose joefikase.

Figura 33: Performanca e administratës tatimore




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

7.3. Perceptimet e bizneseve lidhur me doganën dhe sektorin financiar

Performanca e Doganave u radhit si pengesa e pestë për zhvillimin e afarizmit; megjithatë, edhe në këtë rast, pyetjet tjera dëshmuar se 39% të bizneseve vlerësojnë se performanca e doganave është mesatare (Figura 34). Për më tepër, 28% deklarojnë se Doganat janë tejet joefikase ose joefikase, ndërsa 33% vlerësojnë se ky institucion është shumë efikas ose efikas.


Figura 34: Performanca e Doganave



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Lehtësia e qasjes në financave është gjithmonë mes komponentëve më të rëndësishëm për zhvillimin e afarizmit. Rreth 22% të kompanive të këtij sektori thonë se qasja në financa është e vështirë apo shumë e vështirë, 74% e vlerësojnë këtë qasje si mesatarisht të vështirë dhe 4% thonë se është lehtë tu qasësh financave (Figura 35).

Figura 35: Lehtësia e qasjes në financave për sektorin e TIK




Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Megjithatë, bizneset nuk kanë mendim të njëjtë kur flitet për koston e financave apo normave kamatore. Edhe pse 45% mendojnë se normat kamatore janë rreth mesatare, 41% thonë se kamatat janë të larta ose shumë të larta (Figura 36). Përderisa 14% konsiderojnë se normat kamatore janë të ulëta, asnjë nga të anketuarit nuk ka deklaruar se normat kamatore janë shumë të ulëta.³³

33. Norma kamatore efektive për kredi të reja për muajin tetor të vitit 2013, e cila është raportuar nga Banka Qendrore e Kosovës, ka qenë 11.72% (Buletini i statistikave mujore (Nr. 146), tetor 2013).

Figura 36: Kostoja e financimit (kamatat e kredive)



Burimi: Anketa e UNDP, 2013

Rubrika 6: Lista e tatimeve dhe taksave të zbatueshme për industrinë

Aktualisht në këtë sektor aplikohen të gjitha taksat dhe tatimet e përgjithshme, përveç për disa produkte të TIK që lirohen nga taksat doganore ("Ligji për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me normë zero të tatimit doganor")³⁴.

Tatimi i Vlerës së Shtuar³⁵:

16% Tatimi në Fitim: 10%

Tatimi i Mbajtjes në Burim: 10% maksimum, progresive

Kontributi Pensional (nga paga bruto): 5% punëdhënësi dhe 5% punëmarrësi **Tatimi në eksport: 0%**

Taksat doganore³⁶: 10% për import (përjashtimet vlejné për shtetet të cilat janë pjesë e marrëveshjeve për tregti të lirë; dhe për disa produkte të caktuara të TIK).

34. [http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Mallrat%20e%20Liruara%20nga%20tatimi%20doganor%20\(anglisht\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Ligji%20per%20Mallrat%20e%20Liruara%20nga%20tatimi%20doganor%20(anglisht).pdf)

35. www.kpmg.com/AL/en/IssuesAndInsights/Documents/2013-Tax-card-Kosovo-EN-web.pdf

36. www.rks-gov.net/en-US/Bizneset/Financat/TaksatDoganat/Pages/default.aspx

8. Konkluzion

Sektori i KPA-QPK në fushën e Teknologjisë Informative është mjaft i vogël dhe përbëhet nga rreth 25 kompani, shumica prej të cilave punësojnë më pak se 10 punëtorë. Shumica e kompanive të TIK janë biznese individuale të themeluara mes vitit 2000 dhe 2009. Sektori i KPA-QPK është në fazat e hershme të zhvillimit dhe ofron kryesisht produkte softuerike dhe shërbime përkrahëse për konsumatorë, si në vend ashtu edhe për eksport. Edhe pse ky sektor deklaron se është i kënaqur me nivelin e arsimimit dhe fuqinë punëtore në dispozicion, për të kaluar në ofrimin e aktiviteteve më të vlefshme, kompanitë duhet të ndajnë më shumë resurse për ngritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. Të rëndësishme kyçe në këtë drejtim janë ngritja e kapaciteteve teknike dhe në fushën e menaxhimit, e cila nuk duhet lënë anash ngase kjo do të mund të përbënte pengesë për zhvillimin e sektorit në të ardhmen.

Lënda e parë dhe produktet e ndërmjetme janë faktorët që diktojnë kostot e këtij sektori, edhe pse 30% të kontributeve prodhohen nga vetë kompanitë. Një tjetër kosto e theksuar janë pagat e fuqisë punëtore, megjithatë, Kosova ende vazhdon të ketë çmime konkurruese krahasuar me vendet tjera të zhvilluara. Sa i përket teknologjisë dhe makinerisë së shfrytëzuar, gati 86% të bizneseve janë pronare të aseteve që i shfrytëzojnë, por vlera e tyre ka rënë për 44% gjatë periudhës 2011-2012. Kjo mund të ketë qenë rezultat i ngritjes së nivelit të shfrytëzimit të kapacitetit të tyre përbrenda industrisë, me gjithë faktin se niveli i shfrytëzimit vazhdon të jetë mesatar apo edhe i ulët. Prodhimi vjetor është relativisht më i ulët se sa në vitin 2011, pasi që numri i kompanive që kanë raportuar prodhimtari gjatë intervalit ka shënuar rënie. Në anën tjetër, investimet nga vetë bizneset në zhvillim dhe hulumtim vazhdojnë të mbesin të ulëta, ndërsa edhe proceset e inovacionit në prodhimtari dhe veprimtari tjera funksionale zhvillohen në nivel të ulët.

Sa i përket fuqisë blerëse, zinxhiri i vlerave të kësaj industrie përbëhet nga blerës të ndryshëm, në të cilën blerësit vendorë si përdorues fundorë përbëjnë grupin më të madh. Në anën tjetër, shitësit me pakicë konsiderohen blerës primarë në tregun e jashtëm. Me fjalë tjera, pothuajse të gjitha bizneset i shesin së paku 50% të produkteve dhe shërbimeve të tyre në tregun vendor. Eksportet vazhdojnë të jenë shumë të ulëta për tërë industrinë e TIK, ndërsa deficitit tregtar është mjaft i lartë. Gjatë viteve 2011 dhe 2012 eksportet kanë rënë në mënyrë drastike për rreth 57.87%, edhe pse vëllimi i përgjithshëm i eksporteve ka qenë pothuajse i parëndësishëm (vetëm €210,661). Në sektorin e KPA-QPK shumica e bizneseve eksportojnë produktet dhe shërbimet e tyre brenda rajonit të Ballkanit, si dhe në Gjermani, si një nga vendet e Evropës perëndimore ku eksportohet më së shumti. Rritjen e këtij sektori po e pengojnë barrierat të ndryshme të jashtme, siç janë marrëdhëniet politike me shtetet në të cilat eksportohet apo paaftësia për të krijuar marrëdhënie me tregje të jashtme. Por, edhe strukturat e brendshme të menaxhimit dhe strategjitë e komercializimit të produkteve duket të mos jenë shumë efektive.

Kosova ka të lidhura marrëveshje tregtare dhe bilaterale me vende tjera, por produktet dhe shërbimet e sektorit të TIK nuk janë pjesë ekskluzive e marrëveshjeve të tilla. Kjo është një çështje të cilën qeveria dhe shoqatat e ndryshme relevante duhet të përpiqen ta zgjidhin në të ardhmen. Në anën tjetër, niveli i lartë i tatimit

dhe korrupsionit po e dëmtojnë sektorin e KPA- QPK, si edhe pengesat tjera siç janë tregu i hirtë apo mosefikasiteti i institucioneve publike. Për të adresuar problemet e ndryshme të industrisë së TIK që prekin dhe preken nga shumë akterë të sektorit publik dhe privat, ekziston nevoja urgjente për të krijuar një agjenci të centralizuar brenda një institucioni të caktuar. Kësisoj, sektori i TIK në përgjithësi, dhe i KPA-QPK në veçanti do të mund të merrej drejtpërdrejt me çështje të rëndësishme pranë institucioneve publike dhe jo të mundohet t'i adresojë ato përmes kanaleve të ndryshme. Sfidat si kjo e fundit përbëjnë vështirësi në mjedisin afarist dhe pengojnë zhvillimin e bizneseve të reja të cilat janë duke u shfaqur në treg rishtas. Prandaj, përkrah adresimit të mosefikasitetit në fjalë, qeveria duhet të ofrojë masa stimuluese këtë sektor përmes mekanizmave dhe politikave të ndryshme, me të cilat nxitet rritja e tij.

9. Shtojcat

Shtojca 1: Institucionet publike që ndërlidhen me sektorin e TIK

Kjo industri ka ndikim ndërsektorial dhe prek shumë akterë të ndryshëm nga sektori publik dhe ai privat, prandaj, edhe vetë kjo industri ndikohet nga shumë akterë të ndryshëm. Institucionet dhe agjencitë relevante për këtë sektor bëjnë pjesë në struktura të ndryshme publike. Nuk ekziston ndonjë entitet i centralizuar brenda ndonjë institucioni publik i cili do të ishte i autorizuar për të promovuar dhe mbikëqyrur funksionimin e sektorit apo implementimin e legjislacionit përkatës. Kjo çështje gjithmonë është ngritur tek qeveria nga STIKK; megjithatë, deri tani, progresi në këtë drejtim ka qenë i pakët. Andaj, ekziston nevoja urgjente për të krijuar një agjenci të centralizuar brenda një institucioni të caktuar, e cila do të merrej me çështjet më të rëndësishme për sektorin dhe e cila do të bashkërendonte aktivitetet e institucioneve tjera publike.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (www.mti-ks.org)

Dy agjenci të ndryshme nën këtë Ministri ndikojnë në funksionimin dhe efektivitetin e bizneseve të sektorit: ARBK dhe Agjencia Kosovare për Standardizim. Përveç këtyre, Agjencia e Pronës Industriale brenda kësaj ministrie merret me të drejtat e pronës intelektuale, të cilat janë kyçe për funksionimin e bizneseve të këtij sektori.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (www.mkrs-ks.org)

Kjo ministri mbikqyrë dhe bashkërendon funksionimin e Zyrës së të Drejtave Autoriale dhe të Drejtave tjera të Ndërlidhura³⁷ e cila merret me çështje që ndërlidhen me të drejtat e autorit, pjesë tjetër vitale kjo e të drejtave të pronës intelektuale.

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKE) (www.arkep-rks.org)

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), si organ i pavarur, është kryesisht përgjegjës për rregullimin e sektorit të telekomunikacionit (përfshirë ofruesit e shërbimeve të internetit). Ai ka të drejtë të lëshimit dhe revokimit të licencave apo pëlqimeve, duke zbatuar rregulloret dhe ligjet të cilat e autorizojnë atë.³⁸

Ministria e Infrastrukturës (www.mi-ks.net)

Kjo ministri nuk është e ndërlidhur drejtpërsëdrejti me këtë sektor; megjithatë, ajo punon bashkë me ARKEP në përgatitjen e infrastrukturës së rrjetit të telekomunikacionit që kalon nëpër toka publike, rrugë, autostrada dhe hekurudhë.

37. <http://www.mkrs-ks.org/?page=2,102>

38. <http://www.arkep-rks.org/?cid=2,7>

Kjo ministri luan rol kyç në zhvillimin e politikave dhe programeve arsimore dhe ndërlidhet me këtë sektor në shumë nivele të ndryshme. Për shembull, së fundmi kanë bashkëpunuar në hulumtimin e mundësive dhe potencialeve të ndryshme për hulumtime dhe zhvillime në fushë e TIK në Kosovë (STIKK & SEERC, 2013). Megjithatë, në përgjithësi, komuniteti i TIK do të mirëpriste një nivel më të lartë bashkërendimi mes kësaj ministrie dhe sektorit privat.

Shtojca 2: Shoqatat afariste në sektorin e TIK

Shoqata për Teknologji të Informimit dhe Komunikacionit në Kosovë (STIKK) është e përfshirë në shumicën e aktiviteteve që ndërlidhen me industrinë e TIK. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë shoqatë specifike e cila fokusohet vetëm në Kontraktimin e Bizneseve Afariste apo Qendrat për Përkrahjen e Konsumatorëve. Sidoqoftë, STIKK i mbulon çështjet që ndërlidhen me KPA në sektorin e TIK. STIKK është themeluar si shoqatë në vitin 2006 pranë Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe ka qenë aktive që nga viti 2008. Ajo u themelua falë nismës së përbashkët të gjashtë kompanive themeltare nga fusha e TIK dhe me përkrahje nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, përmes Crimson Capital dhe Shoqatës Norvegjeze të TIK (STIKK, 2013).

STIKK është një nga kontribuesit kryesorë në industrinë e TIK dhe deri tani ka publikuar hulumtime dhe qëndrime të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e këtij sektori. Për më tepër, kjo shoqatë vazhdimisht ka qenë e përfshirë në çështje rregullative, hulumtime dhe lobim pranë qeverisë dhe organizatave ndërkombëtare, duke kërkuar paraqitje më të mirë të këtij sektori. Ajo po ashtu organizon konferencë vjetore rajonale për sektorin e TIK, në të cilën trajtohen trendet lokale dhe globale.³⁹ Aktualisht, STIKK është anëtare e Rrjetit Panevropian të NVM-ve të sektorit të TIK dhe e-Afarizmit; Aleancës Botërore të Shërbimeve të TI; dhe Forumit të TIK për Evropën Juglindore. Përveç kësaj, ajo ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Shoqatën Shqiptare të TI dhe ka partneritet të ngushtë me Odën Maqedonase të TI, Shoqatën Bullgare të TIK dhe organizata tjera relevante. STIKK është një nga hisedarët e Qendrës së Inovacioneve të Kosovës⁴⁰ që mund të konsiderohet si një nga shtytësit e aktiviteteve në fushën e ndërmarrësisë dhe inovacioneve në Kosovë, me fokus të veçantë në industrinë e TIK.

39. KosICT - www.kosict.com

40. ICK - www.stikk-ks.org

Shtojca 3: Stimulimi i bizneseve që veprojnë në sektorin e TIK

Korporata Ndërkombëtare e të Dhënave (IDC) ka parashikuar se të hyrat globale nga KPA do të ngriten nga 147 miliardë dollarë në vitin 2010 në 191 miliardë dollarë në vitin 2015.⁴¹ Megjithatë, tregu i sektorit të TIK në Kosovë në vitin 2011 ka arritur shumën e 126.74 milionë dollarë, ndërsa në vitin 2016 pritet të arrijë në 154 milionë dollarë (IDC, 2012). Kjo industri në Kosovë duhet të stimulohet për tu rritur më tej, për të eksportuar shërbimet e veta dhe për të qenë konkurruese në tregun global. Brenda strukturave aktuale qeverisëse nuk ekziston asnjë agjenci, program mbështetës apo politikë tjetër fiskale apo jofiskale që stimulon veprimtarinë në këtë sektor. Andaj, në vijim janë dhënë disa rekomandime të cilat mund të kenë ndikim më pozitiv në zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen.

Përkrahja e kompanive të TIK dhe fuqisë punëtore të tyre

- Të hiqet dorë nga taksat doganore për produktet dhe shërbimet e importuara të TIK (harduer dhe softuer). Së paku të eliminohen ngarkesat doganore për të gjithë harduerët e softuerët që përdoren për qëllim edukative, zhvillimore e hulumtuese.
- Të krijohen politika dhe mekanizma në mënyrë që institucionet arsimore publike dhe private të punojnë së bashku me bizneset e TIK në ristrukturimin e planprogramit dhe përgatitjen e gjeneratave të reja të të diplomuarve, për tu shërbyer nevojave aktuale dhe të ardhme të tregut.
- Të ofrohet përkrahje financiare për studentët në universitete në mënyrë që të mund të marrin certifikata profesionale të TIK përmes vauçerëve të dhënë nga qeveria.
- Të investohet në laboratorë të TIK brenda institucioneve arsimore për të simuluar probleme reale; kështu, studentët do të mund të marrin shkathtësi të cilat nuk mund të përfitohen përmes qasjeve teorike.

Miratimi i nismave dhe aktiviteteve të KPA

- Në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat, të përcaktohen disa firma specifike të huaja me qëllim të stimulimit të sipërmarrjeve të përbashkëta, partneriteteve dhe investimeve të drejtpërdrejta të huaja në KPA.
- Të bashkëpunohet më për së afërmi me ambasadat e shteteve tjera për të ndihmuar procesin e krijimit të partneriteteve më të fuqishme afariste.
- Të udhëzohet dhe përkrahet strategjia e industrisë dhe përpjekjet për përvetësimin e dinamikave pozitive të tregut të KPA, përmes akterëve nga sektori publik dhe privat (ndoshta duke e imituar modelin e Filipineve⁴²).
- Të përkrahet themelimi i një shoqate të orientuar nga KPA – të ngjashme me STIKK dhe në bazë të modelit të NASSCOM⁴³ në Indi.⁴⁴

Të stimulohen kompanitë e huaja, në mënyrë që të tërhiqen IHD në këtë sektor

- Në bashkëpunim me komunat të krijohet infrastruktura e domosdoshme dhe të përcaktohen Zonat e Posaçme Ekonomike (brenda një qyteti, d.m.th. Prishtinës) për të krijuar kushte më të mira për kompanitë e huaja që duan të krijojnë bizneset e tyre brenda parqeve dhe ndërtesave të TIK⁴⁵.

41. <http://www.smh.com.au/business/momentum/outsourcing-to-grow-20121011-27ee8.html#ixzz2kRjFPLw>

42. <http://www.ibpap.org>

43. <http://www.nasscom.in>

44. Rob Gulick, Business Process Outsourcing

45. Për shembull, në Filipine ekzistojnë mbi 140 SEZ të përcaktuara saktësisht për TIK dhe KPA.

- Të ndihmohen kompanitë përmes eliminimit të tatimit të korporatave për një periudhë të caktuar kohore, duke vënë në fuqi një Pushim të Tatimit në të Hyra (eng. ITH) për disa vite pas fillimit të funksionimit të tyre.
- Të ofrohen lirime tjera ekuivalente me 50% të shpenzimeve të trajnimit, të cilat do të mbuloheshin prej 3% nga qeveria kombëtare në tatimin e veçantë prej 5% nga të hyrat bruto;
- Të ofrohet statusi i banorit të përhershëm për të gjithë investitorët që investojnë 350,000 USD apo më shumë në vend.

Shtojca 4: Legjislacioni, rregulloret, licencat dhe lejet e kërkuara

Legjislacioni aktual relevant për sektorin e TIK është paraqitur në Shtojcën 5. Megjithatë, rregulloret të veçanta lidhur me KPA dhe Qendrat për Përkrahje të konsumatorëve nuk ekzistojnë ende, por disa çështje relevante mbulohen brenda legjislacionit në fuqi. Është gjithashtu thelbësore që të vëhen në spikamë disa agjenci dhe institucione që luajnë rol kyç në zbatimin e ligjeve të listuara dhe në rregullimin e këtij sektori. Një nga akterët më të rëndësishëm në këtë drejtim është Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP).⁴⁶

46. <http://www.arkep-rks.org>

Shtojca 5: Legjislacioni lidhur me pronën industriale dhe patenta

<i>Emri i ligjit</i>	<i>Numri i ligjit</i>
Ligji mbi konkurrencën: Neni 12.1 – Marrëveshjet për Pronën Intelektuale dhe Sekretet Afariste http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,123	2004/36
Ligji për patentat http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,127	2004/49
Ligji për dizajnin industrial http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,175	02/L-45
Ligji për markat tregtare http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,190	02/L-54
Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ndërlidhura http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,199	2004/45
Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2004/49 për patentat http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,216	02/L-100
Ligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave pronësore intelektuale http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,391	03/L-170
Ligji për markat tregtare http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,190	04/L-026
Ligji për patentat http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,665	04/L-029
Ligji për dizajnin industrial http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,664	04/L-028

Emri i ligjit	Numri i ligjit
Ligji për telekomunikacionin http://tinyurl.com/ojuzulm	2002/7
Ligji për shërbimet postare http://tinyurl.com/ptr5626	2003/18
Ligji për standardizimin http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,101	2004/12
Ligji për mbrojtjen e konsumatorit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,121	2004/17
Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,185	02/L-23
Ligji për procedurën administrative http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,186	02/L-28
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/12 për standardizimin http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,195	02/L-83
Ligji që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/16 për telekomunikacionin http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,278	03/L-085
Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,340	03/L-131
Ligji për veprimtarinë hulumtuese shkencore http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,132	2004/42
Ligji për standardizimin http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,377	03/L-144
Ligji për shërbimet postare http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,430	03/L-173
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,466	03/L-172
Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimeve kibernetike http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,490	03/L-166
Ligji për shërbimet e shoqërisë së informacionit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,857	04/L-094
Ligji për komunikimin elektronik http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,966	04/L-109
Ligji për mbrojtjen e konsumatorit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,1,191,968	04/L-121
Ligji për veprimtarinë hulumtuese shkencore http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,1013	04/L-135
Ligji për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit http://www.kuvendikosoves.org/?cid=2,191,1022	04/L-145

Punimet e cituara

- BEJKO, A. & SHAUPI, K., 2010. ICT in Kosovo – A Sector Decoded, s.l.: Kosovo Private Enterprise Program, Booz Allen Hamilton, STIKK, IQ Consulting.
- Berisha, V. & Ilazi, B., 2014. Skill Gap Analysis, s.l.: STIKK, EYE.
- Canhasi, V., 2013. Menaxher i Projektit, STIKK [intervistë] (tetor 2013).
- Çavolli, V., 2013. Drejtor Ekzekutiv - STIKK [intervistë] (shtator 2013).
- CBI, 2013. CBI Market Channels and Segments for Information Technology Outsourcing (ITO), s.l.: Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës.
- CEFTA-Sekretariat, 2013. CEFTA Trade Statistics 2013 Half-Year Update, s.l.: s.n.
- ERC, 2011. Analysis of ICT Industry in Kosovo, s.l.: Kosovo Economic Development through Quality and Networking.
- Gulick, R., 2010. Business Process Outsourcing, s.l.: s.n.
- Handjiski, B. & Šestovic, L., 2011. Barriers to Trade in CEFTA region, s.l.: Studim i Bankës Botërore.
- IDC, 2012. Kosovar IT Market Grows Mildly in 2011 after Previous Year's Decline. [Online] Available at: <http://idc-cema.com/eng/about-idc/press-center/50035-kosovar-it-market-grows-mildly-in-2011-after-previous-year-s-decline-says-idc>
- [Accessed 28 September 2013].
- IPAK-MTI, 2010. Invest in Kosovo - Opportunities in Business Processing and Information Technology Outsourcing, Prishtina: Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë.
- Kearne, A., 2011. A.T. Kearney Global Services Location Index 2011, s.l.: s.n.
- KPEP-STIKK, 2011. Skills Gap Analysis for Information and Communication Technology, s.l.: s.n.
- MTI, 2009. Strategy of the industry of Kosova 2009-2013, s.l.: s.n.
- Nimani, Ç., 2013. Destination: KOSOVO. The Outsourcing Journal, Issue Special Edition, pp. 26-29.
- Plakolli Kasumi, L., 2010. Intellectual Property Manual For Kosovo Software Developers, s.l.: USAID-KPEP, STIKK, CLDP.
- Pula, G., 2013. Drejtor Menaxhues dhe Partner Menaxhues, 3CIS [intervistë] (tetor 2013).
- Sadiku, E., 2013. Bashkëthemelues/Inxhinier për Komunikim dhe Media - ZagApps [intervistë] (tetor 2013).
- STIKK, 2012. Standardization in the ICT sector: a barrier or advantage?, s.l.: s.n.
- STIKK, 2013. Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë, s.l.: s.n.
- STIKK, 2013. STIKK @ LinkedIn. [në internet] mund të nxirret në adresën: <http://www.linkedin.com/company/stikk>
- STIKK & SEERC, 2013. Kosovo ICT RTD Technological Audit Report, s.l.: Konsorciumi ICT-KOSEU.
- TWB, 2013. Doing Business 2013 - Economy Profile: Kosovo, s.l.: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore
- TWB, 2014. Doing Business 2014 - Economy Profile: Kosovo, s.l.: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore
- UNDP, 2012. Kosovo Human Development Report 2012 - Private Sector and Employment, Prishtina: United Nations Development Programme / Swiss Development Cooperation Office



